

**LIGJ**  
**Nr. 67/2022**

**PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E BRENDSHME E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË  
BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT, TË PËRFAQËSUAR NGA  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR SHKËMBIMIN E  
INFORMACIONIT PËR QËLLIME TË LIDHURA ME MIGRACIONIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83 e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, për shkëmbimin e informacionit për qëllime të lidhura me migracionin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.9.2022.

**Shpallur me dekreten nr. 13855, datë 27.9.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E BRENDSHME E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE QEVERIA E MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE  
IRLANDËS SË VERIUT, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË  
BRENDSHME PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT PËR QËLLIME TË LIDHURA  
ME MIGRACIONIN**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në vijim të referuar bashkërisht si “Pjesëmarrësit” dhe individualisht si “Pjesëmarrësi”,

*duke pasur parasysh* marrëdhënien e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të imigracionit në Republikën e Shqipërisë dhe Mbretërinë e Bashkuar;

*me dëshirën* për të forcuar më tej bashkëpunimin dypalësh dhe veprimin e përbashkët në luftën kundër migracionit të paligjshëm, për të reduktuar krimet e tjera ndërkufitare dhe për të forcuar administratën civile përgjegjëse për kontrollet e imigracionit;

*duke pranuar* që shkëmbimi i informacioni me objektiv të mirëpërcaktuar mbështet masat kundër migracionit të paligjshëm dhe përpjekjet për sigurinë e kufijve dhe për zbatimin e ligjit, dhe krijon mundësi për ndërtimin e kapaciteteve, nëpërmjet forcimit të lidhjeve përmes rritjes së bashkëpunimit për çështjet e lidhura me imigracionin; dhe

*duke pranuar* që çdo shkëmbim informacioni duhet të kryhet në pajtim me legjislacionin, rregulloret dhe politikat e çdo vendi në lidhje me imigracionin, mbrojtjen e të dhënave personale dhe që duhet të merren masat e duhura mbrojtëse për të mbrojtur informacionin që shkëmbehet; kanë rënë dakord si më poshtë:

## **1. Qëllimi**

1.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi synon shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë të dhënat personale, ndërmjet Pjesëmarrësve, për çështje lidhur me migracionin, për të ndihmuar Pjesëmarrësit në ruajtjen e kontrolleve efikase për migracionin.

1.2 Shkëmbimi i këtij informacioni është një komponent i nevojshëm për ruajtjen e kontrolleve efikase për migracionin që për Pjesëmarrësit përbën interes të rëndësishëm publik dhe ndihmon në forcimin e kufijve tanë përkatës.

1.3 Shkëmbimi i informacionit në lidhje me kriminalitetin, në zbatim të paragrafit 2.2, duhet të jetë në interesin thelbësor publik të Pjesëmarrësve.

## **2. Të përgjithshme**

2.1 Sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë të dhëna personale, duke përfshirë të dhënat personale për shtetasit e tyre.

2.2 Në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, qëllimet lidhur me migracionin nënkuptojnë mënyrën e rregullimit se në cilat raste dhe mbi cilat baza ndonjë person mund të udhëtojë, hyjë apo qëndrojë në një nga vendet Pjesëmarrëse; dhe mbështetjen e përpjekjeve për të parandaluar ose ndjekur penalisht tentativat që pengojnë ose shmangin kontrollin e imigracionit, përfshirë ndjekjet penale për veprimtari të lidhura me të. Sipas rastit dhe në kuadër të veprimtarisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, kjo e fundit mund të përfshijë informacion lidhur me veprimtaritë në luftën kundër terrorizmit, sigurisë kombëtare ose kriminalitetit, të cilat janë objekt i angazhimit dhe bashkëpunimit me agjencitë e tjera përkatëse partnere.

2.3 Asnjë parashikim i këtij Memorandumi Mirëkuptimi, duke përfshirë përfundimin e tij nëse ndodh, nuk synon të cenojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet Pjesëmarrësve sipas marrëveshjeve ose rregullimeve të tjera, me kusht që informacioni i shkëmbyer sipas këtyre rregullimeve të jetë shkëmbyer në një mënyrë të pajtueshme me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

2.4 E gjithë veprimtaria sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të kryhet në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse të legjislacioneve të brendshme të Pjesëmarrësve dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare.

2.5 “Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo shoqëror.

2.6 “Migracion i paligjshëm” i referohet udhëtimit për në territorin ose nga territori, dhe periudhave apo qëllimit të qëndrimit brenda territorit të secilit pjesëmarrës, të cilat nuk janë në përputhje me legjislacionin e atij Pjesëmarrësi, duke përfshirë sjelljen jo në përputhje me ligjet e vendit transit gjatë udhëtimit për në territorin e njërit prej Pjesëmarrësve;

2.7 “Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.

## **3. Procedurat për shkëmbimin e informacionit**

3.1 Çdo shkëmbim informacioni duhet të jetë në përputhje me qëllimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe shkëmbimi do të kryhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale ndërmjet Pjesëmarrësve.

3.2 Pjesëmarrësit synojnë të shkëmbejnë informacion që lidhet me migracionin, nëse Pjesëmarrësi që e jep informacionin ka baza të arsyeshme dhe të vërteta për të besuar se dhënia e informacionit është e nevojshme për Pjesëmarrësin që e merr atë, me qëllim që të realizojë qëllimet në lidhje me migracionin, të përcaktuara në paragrafin 2.2.

3.3 Çdo Pjesëmarrës do të përcaktojë nëse informacioni që ka është i përshtatshëm për t'u shkëmbyer me Pjesëmarrësin tjetër dhe që shkëmbimi lejohet nga legjislacioni i brendshëm i Pjesëmarrësit dhe nga detyrimet ndërkombëtare.

3.4 Nëse pas marrjes së informacionit të shkëmbyer, Pjesëmarrësi që e merr informacionin konstaton informacione shtesë që mund të ndajë mbi subjektin për të cilin shkëmbehen të dhënat, ai do t'ia japë atë informacion Pjesëmarrësit tjetër, në përputhje me legjislacionin e brendshëm përkatës dhe detyrimet ndërkombëtare.

3.5 Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë informacion në mënyrë proaktive dhe/ose në përgjigje të një kërkesë nga Pjesëmarrësi tjetër. Çdo kërkesë e tillë bëhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, me shkrim ose me postë elektronike, dhe duhet të përmbajë arsye të mjaftueshme që mundësojnë që Pjesëmarrësi tjetër të përcaktojë ligshmërinë e nxjerrjes së këtij informacioni.

3.6 Në përputhje me dispozitat e seksionit 5 më poshtë, çdo Pjesëmarrës duhet të përpiqet të sigurojë informacionin e kërkuar nga Pjesëmarrësi tjetër në kohën e duhur, në masën që është e mundur.

3.7 Asnjë Pjesëmarrës nuk do të shkëmbejë të dhëna personale nëse ekziston rrezik që ky informacion mund të përdoret për të shkelur detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

3.8 Pjesëmarrësit nuk do të shkëmbejnë informacion, nëse shkëmbimi, përdorimi apo zbulimi i këtij informacioni mund: i. të shkaktojë që informacioni t'i zbulohet ndonjë qeverie, autoriteti apo individ të një pale të tretë nga i cili subjekti i informacionit kërkon apo i është dhënë mbrojtje sipas Konventës së vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve dhe Protokollit të saj të vitit 1967 për Statusin e Refugjatëve, Konventës së vitit 1984 kundër Torturës, Dënimit dhe Trajtimeve të tjera Më të Keqme, Çnjerëzore ose Poshtëruese, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1976 ose sipas legjislacionit të brendshëm të Pjesëmarrësve, i cili zbaton Konventat apo Protokollin përkatës; ii. t'i japë mundësi subjektit të informacionit që me marrjen e informacionit nga Pjesëmarrësi, të fitojë të drejtën për mbrojtjen e specifikuar më lart; ose iii. ta vendosë subjektin e informacionit apo/dhe familjen e tij/saj në rrezik serioz, duke përfshirë dëbimin me forcë, përndjekjen, torturën apo çdo lloj tjetër lëndimi që parashikohet në Konventën e vitit 1951, Protokollin e vitit 1967, Paktin e vitit 1976 apo Konventën kundër Torturës.

#### **4. Caktimi i oficerëve ndërlidhës**

4.1 Çdo Pjesëmarrës duhet të caktojë oficerë ndërlidhës në autoritetin përgjegjës të Pjesëmarrësve, që autorizohen të shkëmbejnë informacion sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe të njoftojnë me shkrim ose me postë elektronike Pjesëmarrësin tjetër, në lidhje me caktimin apo ndryshimin e oficerëve ndërlidhës. Shkëmbimi i informacionit dhe përgjigjet ndaj kërkesave të bëra sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi komunikohen ndërmjet këtyre oficerëve ndërlidhës të caktuar si pika qendrore kontakti për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Pjesëmarrësve.

4.2 Çdo Pjesëmarrës duhet të emërojë një oficer ndërlidhës, që është përgjegjës për të garantuar zbatimin dhe funksionimin e dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

4.3 Oficerët Ndërlidhës do të kryejnë bashkërisht analiza gjashtëmujore dhe do të përgatisin një raport me gjetjet e tyre, i cili do t'i paraqitet titullarit përkatës të çdo autoriteti të Pjesëmarrësve.

4.4 Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë çdo vit veprimtarinë e shkëmbimit të informacionit sipas këtij rregullimi, me qëllim që të garantojnë se ky Memorandum Mirëkuptimi vijon të plotësojë qëllimin e tij strategjik.

## **5. Informacioni që mund të shkëmbehet**

5.1 Pjesëmarrësit mund të shkëmbejnë informacion duke përdorur mekanizma të sigurt që mund të lidhen me sa më poshtë, por nuk kufizohen vetëm me:

- Migracionin e paligjshëm;
- Lëvizjen e paligjshme të organizuar të njerëzve;
- Falsifikimin dhe mashtrimin me dokumentet në lidhje me imigracionin; dhe
- Veprimtarinë që lidhet me migracionin e paligjshëm të shtetasve të vendeve të Pjesëmarrësve.

5.2 Informacioni mund të shkëmbehet sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi vetëm në masën që është i rëndësishëm, i nevojshëm dhe i përshtatshëm për qëllimet e Pjesëmarrësve në lidhje me migracionin dhe aq sa lejohet nga legjislacioni i brendshëm dhe detyrimet ndërkombëtare të Pjesëmarrësve.

5.3 Pjesëmarrësit duhet të shkëmbejnë informacion vetëm në masën që ky informacion është në dispozicion të tyre dhe për aq kohë sa përhapja e informacionit është e mundur. Llojet e të dhënave që mund të shkëmbehen, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen domosdoshmërisht me:

- ndihmësit e njohur dhe të dyshuar;
- pasagjerë që mbërrijnë me dokumente të pamjaftueshme dhe detajet e tyre të rezervimit për udhëtim;
- adresa të strehëve të sigurta dhe të tjera të ngjashme;
- detaje të automjeteve;
- numra telefoni;
- identitete të tjera/aliase; dhe
- skanime të dokumenteve të udhëtimit dhe numra të dokumenteve të udhëtimit.

5.4 Është e qartë se një Pjesëmarrës nuk është i lirë të shkëmbejë informacion në rastin kur përdorimi ose transferimi i atij informacioni kufizohet me ligj, ose nga kufizime apo konsiderata të tjera të brendshme, ose i nënshtrohet pëlqimit të një subjekti tjetër (qoftë pëlqimit të një subjekti të të dhënave, ose të një autoriteti ose personi tjetër).

5.5 Përdorimi i informacionit të shkëmbyer dhe kufizimet mbi të i nënshtrohen shqyrtimit të mëtejshëm dhe diskutimit konstruktiv ndërmjet Pjesëmarrësve.

## **6. Përdorimi i lejuar dhe përhapja e informacionit**

6.1 Sipas paragrafëve 7.2 dhe 7.5, secili Pjesëmarrës mund ta përdorë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi, për cilëndo prej çështjeve që lidhen me migracionin, siç parashikohet në paragrafin 2.2, duke përfshirë procedurat përkatëse gjyqësore. Për këto qëllime, secili Pjesëmarrës mund t'ia përcjellë këtë informacion autoriteteve të tjera të brendshme, përgjegjëse për përmbushjen e qëllimeve, të cilave ky informacion u nevojitet për përmbushjen e detyrave të tyre zyrtare, duke përfshirë autoritetet që përfshihen në përcaktimin e ligjshmërisë së një subjekti të të dhënave për marrjen e përfitimeve apo shërbimeve publike që lidhen me statusin e imigracionit të subjektit të të dhënave. Pjesëmarrësit duhet të garantojnë që këto autoritete zbatojnë një nivel të mbrojtjes së informacionit dhe kufizojnë përdorimin dhe përhapjen e informacionit në të njëjtën mënyrë që pritet nga Pjesëmarrësit, sipas dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

6.2 Sipas paragrafëve 7.2 deri 7.5 (dhe veçanërisht paragrafit 7.3), nëse informacioni për identitetin dhe/ose dokumentin e identitetit, i shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, specifikon se një subjekt i të dhënave mund të jetë shtetas, ose të ketë status, ose të ketë një lidhje të përcaktuar qartë me një vend të tretë, secili nga Pjesëmarrësit, në masën e lejuar sipas legjislacionit të tij të brendshëm, mund t'ua zbulojë atë informacion autoriteteve përkatëse të atij vendi, për qëllime të verifikimit të identitetit të subjektit të të dhënave dhe/ose përcaktimit të

origjinës së dokumenteve të identitetit në lidhje me ridokumentimin dhe/ose kthimin e subjektit të të dhënave në atë vend.

## **7. Kufizime mbi përdorimin dhe përhapjen e informacionit**

7.1 Përhapja ose përdorimi i informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi për çdo qëllim ose për çdo person të ndryshëm nga ata të përcaktuar në paragrafin 6.1, kërkon miratimin paraprak më shkrim të Pjesëmarrësit që ka dhënë informacionin.

7.2 Çdo përdorim ose përhapje informacioni të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të respektojë legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm dhe detyrimet ndërkombëtare të Pjesëmarrësit që e merr informacionin.

7.3 Specifikisht, asnjë Pjesëmarrës nuk duhet të shkëmbejë, përdorë ose përhapë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, informacion i cili mund t'i vihet në dijeni një qeverie, autoriteti apo personi ndaj të cilit subjekti i të dhënave mbrohet sipas Konventës së vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve, Protokollit të saj të vitit 1967, Konventës kundër Torturës, Dënimit dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, ose sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose sipas legjislacionit të brendshëm të Pjesëmarrësit në zbatim të konventave apo protokolleve përkatëse. Asnjë Pjesëmarrës nuk duhet të shkëmbejë, përdorë ose përhapë informacion tek një qeveri, autoritet apo person, në rrethanat kur në bazë të marrjes së këtij informacioni nga ana e qeverisë, autoritetit ose personit, subjekti i informacionit mund të përfitojë të drejtën për një mbrojtje të tillë.

7.4 Çdo Pjesëmarrës, në një rast të veçantë, me anë të një shenje mbrojtëse ose shenje tjetër, mund të zbatojë kufizime shtesë në lidhje me përdorimin ose përhapjen e informacionit që ka dhënë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, i cili përfshin garantimin që trajtimi i informacionit është në përputhje me politikat, legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm dhe detyrimet ndërkombëtare. Kur ndodh kjo, Pjesëmarrësi tjetër duhet t'i respektojë këto kufizime. Këto kufizime nuk mund të pengojnë aksesin e subjektit siç parashikohet nga paragrafi 10.5.

7.5 Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk synon të pengojë përdorimin ose përhapjen e informacionit rast pas rasti, në masën që ekziston një detyrim për ta bërë këtë sipas ligjeve të Pjesëmarrësit që e merr informacionin. Sipas kësaj dhe në masën që është e zbatueshme, një Pjesëmarrës duhet të njoftojë Pjesëmarrësin tjetër paraprakisht për çdo përdorim ose përhapje të informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi, i cili nuk është në përputhje me dispozitat e Memorandumit të Mirëkuptimit. Gjithashtu, Pjesëmarrësi që e merr informacionin pritet që fillimisht të kërkojë leje me shkrim nga Pjesëmarrësi që e jep informacionin, nëse dëshiron t'ia zbulojë një informacion të tillë subjektit të të dhënave; një gjykatë, duke përfshirë çdo gjykatë administrative; ose ndonjë Pjesëmarrës të tretë, përfshirë shtetet e treta dhe subjektet e tjera. Me anë të kësaj, Pjesëmarrësve u jepet mundësia, sipas rastit, të kërkojnë mospërhapje ose mbrojtje tjetër të informacionit, në masën që e lejon legjislacioni i Pjesëmarrësit që e merr informacionin.

## **8. Transferimi i informacionit**

8.1 Shkëmbimi i informacionit sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të kryhet në mënyrë të sigurt ndërmjet oficerëve ndërlidhës. Proceset, formatet dhe metodat për shkëmbimin e të dhënave duhet të jenë në përputhje, kudo që është e zbatueshme, me çdo standard dhe proces që mund të vendoset bashkërisht nga Pjesëmarrësit.

8.2 Informacioni i transferuar ndërmjet Pjesëmarrësve në rrugë elektronike duhet të jetë i koduar sipas një standardi të miratuar, kur është e mundur.

8.3 Në rast se transferimi elektronik i sigurt nuk është i disponueshëm, një Pjesëmarrës mund të marrë masa që një nga oficerët e tij ndërlidhës t'ia dorëzojë informacionin personalisht një oficeri ndërlidhës të caktuar të Pjesëmarrësit tjetër.

## **9. Siguria e informacionit**

9.1 Çdo Pjesëmarrës duhet të zbatojë masa për autentifikimin, me qëllim që të garantohet kufizimi i aksesit në informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Çdo Pjesëmarrës pritet ta kufizojë aksesin në informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi tek personeli i autorizuar që duhet të vihet në dijeni të informacionit për të kryer

detyrat e tyre zyrtare, për përdorime në përputhje me qëllimet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

9.2 Çdo Pjesëmarrës duhet të garantojë që informacioni i marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk shpërndalet në mënyrë të paautorizuar.

9.3 Informacioni i shkëmbyer duhet të mbrohet me masa administrative, teknike dhe fizike të përshtatshme për sensitivitetin e informacionit. Të dy Pjesëmarrësit duhet që gjithmonë të ruajnë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi në një sistem elektronik dhe/ose manual të sigurt për ruajtjen.

9.4 Të gjithë personat që kanë akses në informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të jenë të arsimuar dhe të trajnuar, në lidhje me trajtimin dhe kufizimet për përdorimin e këtij informacioni, me qëllim që të sigurohet ruajtja e plotë e informacionit dhe zbatimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

## **10. Integriteti i informacionit**

10.1 Informacioni i dhënë dhe i marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, për qëllimet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Një Pjesëmarrës nuk mund të modifikojë informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi pa autorizimin paraprak me shkrim të Pjesëmarrësit që e ka dhënë informacionin.

10.2 Nëse një Pjesëmarrës vihet në dijeni se informacioni që ka dhënë ose që ka marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi është i pasaktë, ai Pjesëmarrës duhet të njoftojë Pjesëmarrësin tjetër lidhur me këtë dhe të mundësohet dhënia e informacionit të saktë.

10.3 Çdo informacion i dhënë nga një Pjesëmarrës duhet të përfshijë detaje të atribuimit; datën e krijimit; klasifikimin e sigurisë dhe kufizimet ose lejet për përdorimin e mëtejshëm, me qëllim që të ndihmohen përpjekjet e arsyeshme për të mbajtur të saktë, të plotë dhe të përditësuar informacionin e shkëmbyer dhe për të garantuar trajtimin dhe përdorimin e tij në formën e duhur.

10.4 Pjesëmarrësit pritët që të marrin në kohë masat e duhura në lidhje me çdo kërkesë të bërë nga Pjesëmarrësi tjetër për akses, shtesa, ndryshime, fshirje ose korrigjime në informacionin e dhënë, duke përfshirë shkatërrimin e të dhënave në rastet kur është e përshtatshme.

10.5 Çdo Pjesëmarrës konfirmon se mban një sistem të aksesueshëm nga individë që pavarësisht nga kombësia ose vendi i tyre i qëndrimit, i lejon individët të kërkojnë informacione rreth tyre të cilat janë marrë në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe të kërkojnë korrigjimin ose shënimin e atij informacioni. Çdo Pjesëmarrës konfirmon gjithashtu se ofron mundësi korrigjimi për personat që kërkojnë një akses, korrigjim ose shënim të tillë, pavarësisht nga kombësia ose vendi i tyre i qëndrimit.

## **11. Mbajtja e informacionit**

11.1 Çdo Pjesëmarrës duhet të vlerësojë përshtatshmërinë e vazhdueshme të informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi për qëllime që lidhen me migracionin dhe të asgjësojë informacionin në mënyrë të sigurt, kur ai nuk është më i nevojshëm për qëllimet e theksuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

11.2 Informacioni që ruhet në një dosje elektronike ose fizike në lidhje me një subjekt të të dhënave, për shkak se ka lidhje të vazhdueshme me atë dosje, mund të ruhet si pjesë e asaj dosjeje në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe politikat e mbajtjes së të dhënave të Pjesëmarrësit që e ka marrë informacionin.

11.3 Informacioni që vihet në listat e vëzhgimit, listat e monitorimit dhe listat e alertit/sinjalizimit ose që mbahet për përdorim të mundshëm në të ardhmen, mund të mbahet gjithashtu për sa kohë që lidhet me kontrollin e migracionit nga ai Pjesëmarrës, deri në një afat maksimal fillestar prej dhjetë vjetësh nga data e marrjes. Si pjesë e rishikimeve të vazhdueshme të këtij informacioni të hedhur, Pjesëmarrësit synojnë të diskutojnë miratimin, përpara periudhës dhjetëvjeçare, për informacionin që duhet të mbahet për një periudhë të mëtejshme.

11.4 Çdo informacion i mbajtur, përveç rasteve të përcaktuara në paragrafët 11.1 deri 11.3 më sipër, i nënshtrohet miratimit paraprak me shkrim të Pjesëmarrësit që ka dhënë informacionin.

## **12. Njoftimet dhe mjetet juridike**

12.1 Çdo Pjesëmarrës, për të siguruar masa të mëtejshme për privatësinë, sigurinë, konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të informacionit që ruan, përpunon dhe transmeton, duhet të njoftojë me shkrim Pjesëmarrësin tjetër, sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, por jo më vonë se 24 orë pasi të vihet në dijeni, për çdo shkelje të sigurisë së sistemeve të informacionit që përmbajnë informacion të shkëmbyer ose për çdo përdorim apo përhapje të paautorizuar të informacionit të shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

12.2 Pjesëmarrësit duhet të marrin masat e duhura sipas legjislacionit administrativ, civil dhe/ose penal, në rast keqpërdorimi, ndryshimi të paautorizuar, fshirjes, aksesit të paautorizuar ose shpërndarjes së informacionit të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi nga punonjësit e tyre, agjentët ose ndonjë Pjesëmarrës i tretë.

## **13. Regjistrimi i veprimeve**

13.1 Pjesëmarrësit duhet të regjistrojnë informacionin e dhënë dhe të marrë sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, duke përdorur një kuadër të vendosur bashkërisht. Kjo nuk cenon regjistrimet e tjera që ata mund të mbajnë në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm të zbatueshëm dhe politikat dhe udhëzimet për mbajtjen e të dhënave.

## **14. Pajtueshmëria dhe auditimi**

14.1 Secili Pjesëmarrës mund të kërkojë garanci nga Pjesëmarrësi tjetër se janë në funksionim masa të mjaftueshme mbrojtëse në lidhje me informacionin e shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, i cili mund të përfshijë kërkesën për një auditim të masave mbrojtëse. Pjesëmarrësi prej të cilit kërkohet auditimi mund të rakordojë që auditimi të kryhet nga një audit i përshtatshëm, sipas termave të referencës që duhet të vendosen bashkërisht nga Pjesëmarrësit.

14.2 Pjesëmarrësit duhet të përpiqen të trajtojnë çdo mangësi në masat mbrojtëse pas një auditimi sipas paragrafit 14.1 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Megjithatë, nëse lind një situatë ku një Pjesëmarrës e çmon të nevojshëm të refuzojë shkëmbimin e informacionit të mëtejshëm sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, në pritje të një vendimi për çështjen, duhet t'i dërgojë njoftim me shkrim Pjesëmarrësit tjetër. Ky njoftim duhet t'i nënshtrohet konsultimit të menjëhershëm ndërmjet Pjesëmarrësve.

## **15. Raportet për performancën dhe menaxhimin**

15.1 Pjesëmarrësit duhet të përgatisin bashkërisht, çdo vit, një raport për vëllimin e informacionit të shkëmbyer; llojin e informacionit të shkëmbyer; rastet kur shkëmbimi dha një kontribut të dukshëm në vendimet e imigracionit dhe numrin e ndjekjeve penale të kryera si rezultat i shkëmbimeve. Raporti duhet të bazohet në masat e performancës dhe menaxhimit, të vendosura bashkërisht dhe duhet të përfshijë, por nuk kufizohet me numrin dhe shkallën e çdo shkeljeje të sigurisë/privatësisë së informacionit të shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, si edhe një përmbledhje të masave korrigjuese të ndërmarra. Raporti i paraqitet Drejtorit përkatës të çdo Organizate.

## **16. Modifikimi dhe konsultimet**

16.1 Pjesëmarrësit synojnë të informojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim në legjislacion, politika ose detyrimet e tyre përkatëse ndërkombëtare që mund të prekin funksionimin ose interpretimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

16.2 Pjesëmarrësit mund ta ndryshojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi herë pas here, siç vendoset bashkërisht me shkrim, dhe të bëjnë ndryshime në funksionimin e tij, siç parashikohet nga dispozitat e tij specifike, me kusht që këto modifikime dhe ndryshime të jenë në përputhje me qëllimin dhe natyrën fillestare të Memorandumit të Mirëkuptimit.

## **17. Zbatimi dhe interpretimi**

17.1 Ky Memorandum shpreh mirëkuptimin e Pjesëmarrësve. Ai nuk synon të krijojë detyrime ligjore, as të krijojë ose t'i japë ndonjë të drejtë, privilegj ose përfitim ndonjë personi ose Pjesëmarrësi, qoftë privat ose publik.

17.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Pjesëmarrësve që lind nga interpretimi ose zbatimi i ndonjë aspekti të kësaj marrëveshjeje mund të zgjidhet me konsultim të ndërsjellë, pa iu referuar ndonjë Pjesëmarrësi të tretë ose gjykatës ndërkombëtare.

17.3 Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk duhet të cilësohet se pengon ndonjë nga Pjesëmarrësit të bashkëpunojë ose të japë ndihmë, në përputhje me dispozitat e traktateve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të zbatueshme, marrëveshjeve të tjera, ligjeve të brendshme dhe praktikave përkatëse.

## **18. Financimi**

18.1 Pjesëmarrësit do të mbulojnë kostot e tyre dhe do të përdorin pajisjet dhe burimet e tyre njerëzore për kryerjen e veprimtarive të tyre sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

## **19. Fillimi dhe përfundimi**

19.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi pas konfirmimit nga të dy Pjesëmarrësit, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që Pala Shqiptare ka përfunduar të gjitha procedurat e brendshme që parashikohen në legjislacionin e saj për hyrjen në fuqi të Memorandumi të Mirëkuptimit dhe që Mbretëria e Bashkuar është gati për zbatimin e tij. Memorandumi i Mirëkuptimit do të vazhdojë të jetë në fuqi për një kohë të pacaktuar, përveç rastit kur përfundon sipas paragrafit 19.2.

19.2 Ndryshe nga sa parashikohet në paragrafin 19.1 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, pjesëmarrja në këtë Memorandum Mirëkuptimi vazhdon deri në momentin që ose nëse njëri Pjesëmarrës nuk dëshiron më të vazhdojë veprimtaritë e tij sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet të bëhet 90 ditë përpara.

19.3 Nëse veprimtaritë nuk zhvillohen më, të dhënat që janë marrë nga Pjesëmarrësit mbahen për t'u përdorur dhe më pas asgjësohen, në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

19.4 Pjesëmarrësit rikonfirmojnë angazhimin e tyre për të punuar dhe shkëmbyer informacione në lidhje me imigracionin, sipas përcaktimit në këtë Memorandum Mirëkuptimi. Përveç rrethanave të tilla që specifikohen dhe kërkojnë vendim, sipas paragrafit 14.2 të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, secili Pjesëmarrës duhet të vazhdojë me besnikëri këtë bashkëpunim në mënyrë të plotë.

Nënshkruar në \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_.2022, në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze dhe shqipe, ku të dyja tekstet kanë vlefshmëri të barasvlershme.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Ministër i Brendshëm**

PËR QEVERINË E MBRETËRISË SË BASHKUAR  
TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT  
**Në emër të Sekretarit për Punët e Brendshme**